

Realizimi i  
Planit të Punës së  
Këshillit Gjyqësor  
të Kosovës (KGJK)  
për vitin 2022



TITULLI:

**Realizimi i Planit të Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2022**

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

Korrik, 2023

WEBSITE:

[www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

ADRESA:

Andrea Gropa, No.35 10000 Prishtinë, Kosovë

**Të drejtat e autorit @ 2023.** Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

\*Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

# Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	5
2. Metodologjia	7
3. Hyrje	8
4. Realizimi i Planit të Punës së KGJK-së	9
4.1 Besimi dhe Besueshmëria e Publikut	10
4.2 Administrimi Efektiv dhe Efikas i Drejtësisë	11
4.3 Avancimin i Kompetencës Profesionale Gjyqtarëve Porotë dhe Stafit jo Gjyqësor	14
4.4 Transparenca dhe Llogaridhënia	16
4.5 Qasja në Drejtësi	18
4.6 Luftimi i Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	20
4.7 Miratimi I Legjislacionit Sekondar	22
4.8 Plane tjera të KGJK-së	24
4.9 Monitorimi i Zbatimit të Kornizës Ligjore dhe Rregullative	26
5. Vlerësimet e Organizatave të Shoqërisë Civile për Realizimin e Planit të Punës së KGJK-së të vitit 2022	28
6. Rekomandime	29

# Akronimet

<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>SKGJK</b>	Sekretariati Këshillit Gjyqësor të Kosovës
<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>KAGJ</b>	Komisioni për Administrimin e Gjykatave
<b>KÇN</b>	Komisioni për Çështje Normative
<b>KVPGJ</b>	Komisioni për Vlerësimin e Performancës
<b>KBF</b>	Komisioni për Buxhet dhe Financa
<b>DBF</b>	Departamenti për Buxhet dhe Financa
<b>DLO</b>	Departamenti për Logjistikë
<b>DL</b>	Departamenti Ligjor i Këshillit
<b>DS</b>	Departamenti i Statistikave
<b>ZP</b>	Zyra e Prokurimit
<b>ZTIK</b>	Zyra për Teknologji Informative
<b>NjIGJ</b>	Njësi për Inspektim Gjyqësor
<b>SKEQP</b>	Sistemi Kombëtar i Evidencës Qendrore Penale
<b>SMIL</b>	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve

# 1. Përmbledhja Ekzekutive

Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2022, parashihte realizimin e 9 objektivave, brenda të cilave gjendet një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të cilat ishin të parapara të implementoheshin deri në fund të vitit 2022.

Sipas të dhënave të pranuar nga KGJK, nga 138 aktivitete sa ishin paraparë të realizohen në Planin e Punës së KGJK-së të vitit 2022, KGJK kishte arritur të përmbush 86 prej tyre, ndërsa 52 aktivitete të tjera nuk kishin arritur të finalizoheshin brenda kohës së paraparë në këtë plan.

Pra, Këshilli Gjyqësor i Kosovës kishte arritur të përmbush 62% të Planit të Punës për vitin 2022, ndërsa pjesa tjetër prej 38% ka mbetur e përealizuar.

Niveli i përmbushjes së Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022 në tërësi (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.


**62%**

I REALIZUAR

Realizimi i Planit të Punës së Këshillit  
Gjyqësor të Kosovës për vitin 2022

**38%**

I PAREALIZUAR



Grafikoni 1. Niveli i përmbushjes së Planit të Punës së Këshillit Gjyqësor të vitit 2022.

Rëndësi e posaçme në përpilimin e objektivave të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022 i ishte kushtuar llogaridhënies, transparencës, qasjes në drejtësi për publikun, administrimit efektiv të drejtësisë, avancimit të sistemit të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, avancimit të sistemit teknologjik, trajtimit të rasteve të bartura, bashkëpunimit me institucione vendore dhe me partnerë ndërkombëtar, avancimin e kuadrit ligjor për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe miratimin e legjislacionit sekondar. Rëndësi të veçantë gjatë përpilimit të këtij plani i është kushtuar edhe administrimit efektiv dhe efikas të drejtësisë ku në këtë objektivë janë paraparë realizimi i 50 aktiviteteve, realizimin e të cilës do t'a shtjellojmë më poshtë.

Sipas informatave të pranuar nga KGJK<sup>1</sup>, objektivat të cilat janë realizuar në tërësi janë: besimi dhe besueshmëria e publikut, e cila parashihte implementimin e 3 aktiviteteve prej të cilave 2 janë realizuar gjatë vitit 2022 dhe 1 ka arritur të realizohet tre muaj me vonë.

Pastaj transparenca dhe llogaridhënia është objektiva tjetër që parashihte realizimin e 16 aktiviteteve prej të cilave vetëm 1 nuk ka arritur të realizohet e të cilat përfshinin themelimin e një trupi për këshilldhënie për etikë, plane vjetore të auditimit të brendshëm, trajnim të komisioneve dhe publikim të vendimeve të paneleve për lirim me kusht.

Objektivë tjetër e cila ka arritur të implementoj 12 aktivitete në tërësi është objektiva rreth planeve të tjera të KGJK-së që përfshin: planifikimin e buxhetit, shpenzimet e buxhetit si dhe monitorimet e punës së gjykatës për zbatimin e udhëzimit administrativ Nr.01//2019 për ndarjen e përgjegjësive të SKGJK-së dhe gjykatave në çështjet e personelit, buxhetit dhe planifikimit të prokurimit.

Mirëpo, vlen të theksohet se edhe objektivat e tjera të parapara në Planin e Punës së KGJK-së kanë arritur të realizohen deri në një masë të konsiderueshme ku disa prej tyre janë: administrimi efektiv dhe efikas i drejtësisë, miratimi i legjislacionit sekondar, monitorimi i zbatimit të kornizës ligjore dhe rregullative etj.

Sa i përket objektivës së gjashtë e cila ka të bëjë me luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, vetëm një nga 8 aktivitetet e parapara ka arritur të realizohet gjatë vitit 2022.

Rreth aktiviteteve të publikuara në ueb faqen zyrtare të KGJK-së, kemi vërenjtur se jo të gjitha aktivitetet e kryera janë publikuar në ueb faqen zyrtare, ndër to ishte objektiva e pestë apo ndryshe objektiva qasja në drejtësi për të cilën nuk ka ndonjë aktivitet të publikuar në ueb faqe zyrtare, pastaj objektiva e tetë rreth planeve tjera të KGJK-së, për të cilën gjithashtu nuk është gjetur ndonjë aktivitet i publikuar në ueb faqe.

Si sfidë kryesore e KGJK-së rreth implementimit të objektivave dhe realizimit të aktiviteteve, është theksuar mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit, inkorporimi i disa objektivave nga plani i veprimit i strategjisë për sundim të ligjit, si dhe koha e shkurtër për të përmbyllur të gjithë ciklin e aktiviteteve.

1 Përgjigjja e KGJK-së e dërguar me datë 13.06.2023

## 2. Metodologjia

Ky raport ka për qëllim matjen sa më të saktë të përmbushjes së aktiviteteve të parapara në Planin e Punës së Këshillit Gjyqësor për vitin 2022, plan i cili është miratuar nga ana e këtij institucioni në mbledhjen e mbajtur me 21 dhjetor 2021 dhe përmban objektivat kryesore për ngritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së gjykatave.

Për përpilimin e këtij raporti, Lëvizja FOL ka përdorur metodën e intervistimit të zyrtarëve përgjegjës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në lidhje me nivelin e realizimit të secilit aktivitet dhe objektivë të paraparë në Planin e Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe për sfidat me të cilat është përballur këshilli gjatë realizimit të të njejtave. Intervistimi i zyrtarëve përgjegjës është bërë përmes pyetjeve të parashtruara me shkrim.

Përveç zyrtarëve përgjegjës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, FOL ka realizuar edhe intervista me organizata të shoqërisë civile të cilat kanë monitoruar gjithashtu përmbushjen e Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022. Në intervistat e realizuara, janë diskutuar disa nga vlerësimet e organizatave nga monitorimi i planit të punës dhe të njëjat janë inkorporuar në këtë raport.

Para publikimit të raportit, ne e kemi dërguar këtë raport edhe tek zyrtarët përgjegjës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të adresuar komentet apo rekomandime eventuale në lidhje me të gjeturat.

### 3. Hyrje

Duke marrë parasysh rëndësinë dhe peshën e madhe të përgjegjësisë së institucioneve të sistemit gjyqësor e sidomos Këshillit Gjyqësor të Kosovës si një ndër institucionet më të rëndësishëm në vend dhe në këtë drejtim, me qëllim të zbatimit të projektit "Rritja e transparencës dhe edukimit të rinjve në sektorin e drejtësisë", me mbështetjen e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL), Lëvizja FOL ka analizuar nivelin e realizimit të Planit të Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2022.

Përmes këtij raporti synohet krijimi i një pasqyre të përgjithshme në lidhje me nivelin e përmbushjes së objektivave dhe aktiviteteve të parapara në këtë plan të punës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion i pararur, me mandat edhe përgjegjësi të rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me Ligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka për detyrë kushtetuese dhe ligjore që të siguroj qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Republikën e Kosovës. Ndërkaq, me qëllim të zbatimit të Planit Strategjik 2023 – 2025, Këshilli Gjyqësor i Kosovës çdo vit harton plane vjetore të punës. Përveç planit vjetor të punës Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), gjithashtu ka miratuar edhe planin për sistematizimin, digjitalizimin dhe automatizimin e arkivave për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili përshkruan veprime specifike se si të trajtohen problemet në rritje me materialet arkivuese në gjykata dhe prokurori.

Në Planin Vjetor të Punës së KGJK-së për vitin 2022 janë paraparë objektivat kryesore dhe aktivitetet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rrjedhimisht, mund të konkludojmë se objektivat institucionale të cilat Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) i kishte vënë vetes në këtë plan shtrihen në drejtim të fuqizimit të kornizës ligjore që rregullon fushëveprimtarinë e saj institucionale, ngritjen e llogaridhënies, transparencës dhe komunikimit me publikun dhe mediet, fuqizimin e integritetit institucional, avancimin e sistemit të performancës, trajtimin e lëndëve të bartura nga periudha e kaluar, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe personelit institucional etj.

Të dhënat që përmban ky raport hulumtues si burim e kanë ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Gjithashtu, me qëllim të matjes së saktë të përmbushjes së objektivave dhe realizimit të aktiviteteve nga këto plane të punës, Lëvizja FOL ka hartuar një pyetësor në lidhje me nivelin e realizimit të secilës objektivë të paraqitur në këto plane. Në këtë mënyrë, nga përgjigjet dhe të dhënat e pranuar, FOL ka bërë përmbledhjen strukturore të të dhënave, analizimin në drejtim të aritjes së përmbushjes në kohën e paraparë, si dhe llogaritjen e rezultateve duke u bazuar në indikatorët matës.

Duke u nisur nga premisa se ky raport pasqyron në formë statistikore nivelin e përmbushjes së planit vjetor të punës, duhet bërë e qartë se në këtë raport nuk synohet matja e cilësisë së objektivave dhe aktiviteteve të përmbushura nga këto plane, apo efektshmëria e tyre, por analizohet vetëm aspekti kuantitativ i përmbushjes së këtyre planeve.




## 4. Realizimi i Planit të Punës së KGJK-së

Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin 2022, parashihte realizimin e 9 objektivave, brenda të cilave gjendet një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të cilat ishin të parapara të implementoheshin deri në fund të vitit 2022.

Sipas të dhënave të pranuar nga KGJK<sup>2</sup>, nga 138 aktivitete sa ishin paraparë të realizohen në Planin e Punës së KGJK-së të vitit 2022, KGJK kishte arritur të përmbush 86 prej tyre, ndërsa 52 aktivitete të tjera nuk kishin arritur të finalizoheshin brenda kohës së paraparë në këtë plan.

Niveli i përmbushjes së Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022 në tërësi (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

Në vijim të këtij raporti janë shtjelluar të dhënat në lidhje me nivelin e realizimit të aktiviteteve të secilës objektive të këtij plani, si dhe publikimin e tyre në ueb faqen zyrtare të KGJK-së.



Grafikoni 2. Përqindja e realizimit të Planit të Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2022.

## 4.1 Besimi dhe Besueshmëria e Publikut

Në kuadër të objektivës së parë të KGJK-së, ishte paraparë realizimi i 3 aktiviteteve me afat të përmbylljes deri në dhjetor të vitit 2022. Prej tyre, KGJK kishte realizuar vetëm 2 aktivitete gjatë periudhës kohore të paraparë në plan, ndërsa 1

aktivitet ka arritur të realizohet në muajin e tretë të vitit 2023.

Vlen të theksohet se nga kjo objektivë ka edhe dokumente të cilat vërtetojnë se të njëjtat janë realizuar, ku sipas hulumtimeve

tona në ueb faqe të KGJK-së, gjenden: strategjia e komunikimit, foto rreth takimeve me shoqërinë civile dhe gjithashtu rregullorja për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe klasifikim të dokumenteve.



### SIPAS PËRGJIGJJES SË KGJK-SË, AKTIVITETET E PËRFUNDUARA TË KËSAJ OBJEKTIVE ISHIN:

- ✓ Hartimi i Strategjisë së re të Komunikimit;
- ✓ Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta për avancimin e raporteve ndërmjet gjyqësorit me media, shoqërinë civile dhe publikun;
- ✓ Hartimi i Rregullores për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe klasifikim të dokumenteve, aktivitet i cili është vonuar të implementohet deri më 31.03.2023, pra 3 muaj më vonë.

## 4.2 Administrimi Efektiv dhe Efikas i Drejtësisë

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 50 aktiviteteve, njëherit është një ndër objektivat me

më së shumti aktivitete të cilat ishin të parapara për vitin 2022. Prej këtyre aktiviteteve, KGJK kishte realizuar 29

aktivitete, ndërsa 21 aktivitete nuk kanë arritur të përfundohen në kohën e paraparë në Planin e Punës.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:

- ✓ Miratimi i planeve vjetore të gjykatave për menaxhimin e lëndëve;
- ✓ Mbikëqyrja e punës së Administratës Gjyqësore;
- ✓ Implementimi i Ligjit për Gjykatën Komerciale;
- ✓ Miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Zvogëlimin e Lëndëve Civile;
- ✓ Rritja e shfrytëzimit të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve;
- ✓ Përgatitja e planit të përgjithshëm të personelit të administratës gjyqësore;
- ✓ Shpërndarja e stafit në gjykata, bazë të strukturës organizative të miratuara në KGJK;
- ✓ Angazhimi efektiv i stafit në punë;
- ✓ Zhvillimi i raporteve statistikore në harmoni me CEPEJ-in;
- ✓ Konsolidimi i bazës ligjore të domosdoshme për operimin e SQPE-së dhe hartimi i procedurave e standarde të veprimit në proceset kryesore të SQPE-së;
- ✓ Ndërlidhja e SKQEP me SMIL;
- ✓ Fillimi i zbatimit të sistemit të ri të certifikatave të gjendjes penale;
- ✓ Fillimi i procesit të rehabilitimit (fshirjes së dënimeve);
- ✓ Bartja e kompetencës së Administrimit të komponentës teknike të SQEP-së;
- ✓ Shkëmbim i drejtpërdrejtë i të dhënave ndërmjet SEQP dhe SMIL për të siguruar një regjistrim të drejtpërdrejtë;
- ✓ Përfshirja e të dhënave në sistemin e evidencës penale;
- ✓ Largimi i regjistrave manual nga administratori përdorimi i SMIL nga të gjitha gjykatat;
- ✓ Vënja në zbatim e shpërndarjes automatike të lendeve për Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit;
- ✓ Vënia në zbatim e SMIL në Dhomën e Posaçme të gjykatës Supreme të Kosovës;
- ✓ Zbatimi i projektit PAJI të financuar nga MFK për rritjen e publikut të dhënave në gjykata;
- ✓ Vlerësimi i ndikimit të Pandemisë Covid 19 në punën e Sistemit Gjyqësor;
- ✓ Respektimi i afateve lidhur me dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë;
- ✓ Përmirësimi i mënyrës së menaxhimit të dosjeve në mënyrë fizike (regjistrimi, lidhje, etj);
- ✓ Vlerësimi lidhur me numrin e lëndëve të vjetra me të cilat është i ngarkuar secili gjyqtar;
- ✓ Mbikëqyrja dhe përmirësimi i shërbimit për shpërndarjen e shkresave përkatësisht postës, duke evituar mundësin e dështimit të seancave për shkak të shpërndarjes;
- ✓ Vlerësimi dhe Analizimi i kapaciteteve dhe efikasitetit, duke përfshirë vlerësimin e ngarkesës me raste, lëndët e vjetra dhe shpërndarjen e drejtë të numrit të rasteve tek gjyqtarët, e Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- ✓ Koordinimit dhe ndërlidhja e data bazave për shkëmbimin e informatave në mes të AD-së, KGJK-së, për të garantuar mekanizmat e koordinimit në trajnimin e gjyqtarëve;
- ✓ Avancimi i udhëzuesit të Gjykatës Supreme për të siguruar zbatimin e politikave unike të dënimeve nga gjykatat;
- ✓ Vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtar;



### AKTIVITETET TË CILAT NUK KANË ARRITUR TË REALIZOHESHIN GJATË VITIT 2022 JANË:

- ➊ Rishikimi dhe avancimi i formave standarde të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore;
- ➋ Krijimi i Qendrës së përbashkët e thirrjeve KGJK/ KPK;
- ➌ Funkcionalizimi i thirrjeve elektronike nga gjykata drejtuar palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- ➍ Zhvillimin e Sistemit për dosjen e gjyqtarëve;
- ➎ Hartimi i planit strategjik për TIK për KGJK e Gjykata;
- ➏ Përgatitja e politikave dhe procedurave për TIK për departamentin e IT;
- ➐ Aprovimi i SLA për ofrimin shërbimeve dhe përkrahjes për përdorues;
- ➑ Ofrimi i trajnimeve dhe ri trajnimeve për përdorim të SMIL;
- ➒ Ngritja e vetëdijesimit për sigurinë e kibernetike;
- ➓ Angazhimet në zbatimin e projektit të audio dhe video incizimit për gjykata, Financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë;
- ➊ Miratimi dhe zbatimi i planit të rimëkëmbjes në rast të fatkeqësive për qendrën e të dhënave;
- ➋ Ofrimi i shërbimeve online për të realizuar pagesat e taksave gjyqësore;
- ➌ Zbatimi i rekomandimit të CEPEJ për menaxhimin e kohës që në një instance gjyqësore raste të zgjidhen brenda një periudhe dy vjeçare nga dita e paraqitjes së tij;
- ➍ Hartimi i planit për të adresuar vonesat në procedura dhe periudhat e pasivitetit të lëndës;
- ➎ Angazhimi i kryetarëve të gjykatave për të adresuar gjetjet lidhur me këto lëndë tek gjyqtarët përkatës;
- ➏ Ngritje e efikasitetit lidhur me ekzekutimin e lëndëve të gjitha natyrave duke përfshirë lëndët të lëmisë kundërvajtëse, përkatësisht numrin e ekzekutuesve në gjykata, numrin e lëndëve të ekzekutuara, numrin e lëndëve të cilat janë pranuar, si dhe numrin e lëndëve të parashkruara;
- ➊ Publikimi i një buletini mujor elektronik të gjykatës për kompanitë që kanë aplikuar për insolvencë ose falimentim;
- ➋ Miratimi i një plani mbi bazën e analizës se si të rritet numri i masave alternative;
- ➌ Zhvillimi i një metodë të bazuar në Test për të vendosur mbi kërkesat për paraburgim;
- ➍ Mbledhja e të dhënave nga gjykatat për numrin dhe shumën e gjobave të shqiptuara për të pandehurit, përfshirë shumën e kostove procedurale / shumën e paushallit që janë bërë gjatë procedurës penale;
- ➎ Identifikimi i temave për trajnimin e detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët;

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.


Vlen të theksohet se nga kjo objektive ka edhe dokumente të cilat vërtetojnë se të njëjtat janë real-

izuar, ku sipas hulumtimeve tona në ueb faqe të KGJK-së, gjenden: rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Komerciale, udhëzues për transferimin e lëndëve, manuale dhe udhëzues të ndryshëm.

Si sfidë kryesore për mos implementimin e të gjitha aktiviteteve sipas përgjigjes së KGJK<sup>3</sup>-së ka qenë planifikimi i shumë aktiviteteve të cilat edhe janë të inkorporuara nga plani i veprimit i strategjisë për sundim të ligjit.

**58%**

I REALIZUAR



**42%**

I PAREALIZUAR



**Grafikoni 3.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së dytë të Planit të Punës për vitin 2022.

## 4.3 Avancimin i Kompetencës Profesionale të Gjyqtarëve Porotë dhe Stafit jo Gjyqësor

Kjo objektivë përfshinte implementimin e 8 aktiviteteve, të cilat sipas përgjigjes së KGJK-së, 6 prej tyre kanë arritur të përmbushen gjatë afatit të paraparë kohor, ndërsa 2 prej tyre nuk kanë arritur të përfundohen brenda afatit të paraparë kohor.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:

- ✓ Rekrutimi dhe emërimi i gjyqtarëve porotë;
- ✓ Certifikimi i përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor për çiftin e gjuhëve shqip-serbisht dhe anasjelltas dhe anglisht serbisht dhe anasjelltas;
- ✓ Hartimi i një manuali për punën me përkthyes dhe interpret të gjykatave;
- ✓ Hartimi i një manuali për një manuali për punën me përkthyes dhe interpret të gjykatave;
- ✓ Identifikimi i nevojave për trajnimin e stafit administrativ;
- ✓ Vlerësimi i performancës për stafin jo gjyqësor në SKGJK dhe Gjykata për vitin përkatës;
- ✓ Identifikimi i temave për trajnimin e detyrueshëm për gjyqtarët individual;



### AKTIVITETET TË CILAT NUK KANË ARRITUR TË REALIZOHEN GJATË KOHËS SË PARAPARË JANË

- Ofrimi i trajnimeve të përhershme në kudër të AD me Trajnerët/përkthyesit e akredituar të sistemit gjyqësor;
- Përgatitja e planit vjetor të trajnimit të stafit jo gjyqësor të SKGJK dhe gjykatave, në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë;

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.


Sa i përket sfidave rreth implementimit të këtyre aktiviteteve, KGJK në përgjigjen e saj <sup>5</sup> ka potencuar se

për disa aktivitete të cilat ndërlidhen me trajnimet e stafit gjyqësor, dhe për stafin administrativ, KGJK është duke krijuar korikulat për trajnimet e nevojshme dhe kjo do të bëhet varësisht nga nevojat që paraqiten nga fushëveprimtaria e tyre dhe stafit të gjykatës.

Vlen të theksohet se, FOL ka humtuar në ueb faqen e KGJK-së dhe ka gjetur dokumente dhe të dhëna që dalin nga kjo objektive rreth aktiviteteve të realizuara.

**75%**

I REALIZUAR



**25%**

I PAREALIZUAR



**Grafikoni 4.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të përealizuara të objektivës së tretë të Planit të Punës për vitin 2022.

## 4.4 Transparenca dhe Llogaridhënia

Objektiva e katërt e KGJK-së përfshinë implementimin e 16 aktiviteteve, prej të cilave vetëm 1 nuk ka arritur të implementohet gjatë vitit 2022.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së<sup>6</sup>, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:

- ✓ Themelimi i Trupit Këshillëdhënës për Etikë;
- ✓ Përgatitja e plani strategjike të Auditimit të Brendshëm;
- ✓ Përgatitja e plani vjetore të Auditimit të Brendshëm;
- ✓ Raportimi në baza gjashtë mujore për Auditimit e përfunduar dhe vjetore;
- ✓ Pranimi i Planit të Veprimit nga njësitë e audituar, për implementim të rekomandimeve nga menaxhmenti;
- ✓ Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditimit i Brendshëm dhe nga Zyra Kombëtare Auditimit;
- ✓ Auditimi i sistemeve:
  - a) ekzekutimi i buxhetit (pagesat e avokatëve, eksperti, porotë, kthimi i depozitave)
  - b) Auditimi menaxhimi i sistemeve të furnizimit nga njësitë kërkuese
  - c) Auditimi i procedurave të rekrutimit dhe kontratave me shërbim të veçante
  - d) Auditimi i procedurave të prokurimit përmbushja e kontratës
  - e) Auditimi sipas kërkesë (Ad-hoc);
- ✓ Publikimi i rregullt i raporteve të Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve;
- ✓ Avancimin i gjyqtarëve i bazuar në performancë;
- ✓ Trajnimi i komisioneve të vlerësimit të performancës;
- ✓ Ngritja e transparencës lidhur me rekrutimin e gjyqtarëve;
- ✓ Nxjerra e udhëzimeve për mjediset ku mund të zhvillohen seancat gjyqësore;
- ✓ Themelimi dhe mirëmbajtja e databazës elektronike të të dhënave ku regjistrohen të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të dhënat e dorëzuara nga autoritetit kompetent;
- ✓ Publikim i vendimeve nga Paneli i KGJK për Lirim me Kusht;
- ✓ Publikimi i listës me të dhënat e kompensimeve të personave të privuar nga liria padrejtësisht;



### NDËRSA AKTIVITETI I CILI NUK KA ARRITUR TË REALIZOHET GJATË KOHËS SË PARAPARË ËSHTË:

- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për kryerjen e hulumtimeve për matjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor;




Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.

FOL, ka pyetur KGJK-në <sup>7</sup> se si ka realizuar aktivitetin në lidhje me „Themelimin dhe mirëmbajtjen e databazës elektronike të të dhënave ku regjistrohen të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin

e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të dhënat e dorëzuara nga autoriteti kompetent” dhe përgjigjja e KGJK-së ishte se gjatë vitit 2022 ka themeluar data bazën elektronike dhe se çdo herë perditson të dhënat me raste dicitpinore por që ky regjistër nuk është publik dhe përdoret vetem për nevojat e KGJK-së.

Ndërsa sa i përket realizimit të këtyre aktiviteteve në ueb faqen zyrtare të KGJK-së janë gjetur raporti i punës së komisionit për kompensim dëmi për personat e denuar ose arrestuar pa arsye,raporti vjetor i KGJK-së, dhe gjithashtu vendimet e Panelit për Lirim me Kusht.

**94%**  
I REALIZUAR



**6%**  
I PAREALIZUAR



**Grafikoni 5.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së katërt të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022.

7 Pyetësi i dërguar me datë 30.05.2023

## 4.5 Qasja në Drejtësi

Objektiva e 5 e Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022, si një ndër objektivat me rendësi për informimin publik dhe për rritjen e

vetëdijësimit për qytetarët rreth qasjes së tyre në shërbimet që ofron gjykata ka përfshirë implementimin e 10 aktiviteteve. Nga këto

aktivitete, vetëm 3 aktivitete të parapara janë realizuar në tërësi, ndërsa 7 të tjera nuk kanë arritur të realizohen gjatë vitit 2022.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së<sup>8</sup>, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:

- ✓ Përgatitja dhe publikimi i materialeve informuese dhe kampanjave online për udhëzimin e qytetarëve për aktivitetet gjyqësore që zhvillohen në gjykatë;
- ✓ Vazhdimi i punimeve ndërtimore për ndërtimin e objektit të gjykatës në Fushë Kosovë;
- ✓ Hartimi dhe vënia në dispozicion për publikun e informacioneve relevante në gjuhët zyrtare përmes një aplikacioni në telefona të mençur, në të cilin vihen në dispozicion informata si vendndodhja e gjykatës(ave), koha e seancave dëgjimore dhe informacione të ngjashme);



### AKTIVITETET TË CILAT NUK KANË ARRITUR TË REALIZOHEN GJATË KOHË SË PARAPARË JANË:

- Punimi i projektit të objektit të Gjykatës Themelore në Prizren, Pejë dhe Mitrovicë dhe në Drenas;
- Hartëzimi i nevojave të qytetarëve për drejtësi;
- Pilotimi i një pyetësoi lidhur me hartën e nevojave të qytetarëve për drejtësi;
- Përditësimi i portaleve të institucioneve në mënyrë të ofrohen informacione të qarta dhe transparente në lidhje me llojet e mundësive të zgjidhjes alternative të kontesteve, kur ato janë të përshtatshme,
- shpenzimet dhe kohëzgjatja e tyre;
- Përditësimi i portalit 'Gjykata ime' me informacione thelbësore shtesë dhe të thjeshtëzuara për publikun, përfshirë informacionin juridik, shabllonet e dokumenteve që duhet të dorëzohen në gjykatë dhe udhëzimet tjera për publikun;
- Të miratohet vendimi për analizim vjetor të vendimeve gjyqësore në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore për të vlerësuar nëse vendimet janë në përputhje me Udhëzimeve për Dënime në Kosovë;
- Analizimi i SMIL për të parë nëse përfshihen të dhënat e nevojshme për të monitoruar dhe raportuar lëndët e krimeve kundër komunitetit LGBTIQ+ dhe reflektimi i rekomandimeve të kësaj analize në SMIL për të mundësuar monitorimin e hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të krimeve kundër komunitetit LGBTIQ+;


Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.

Ndërsa sa i përket realizimit të këtyre aktiviteteve në ueb faqen

zyrtare të KGJK-së nuk është gjetur ndonjë raport apo aktivitet që ka të bëjë me realizimin e aktiviteteve.

Gjithashtu FOL ka pyetur KGJK-në<sup>9</sup> se cilat kanë qenë sfidat rreth implementimit të këtyre aktiviteteve

dhe përgjigjja e tyre ka qenë se koha nuk ka qenë e mjaftueshme dhe për realizimin e këtyre aktiviteteve në tërësi nevojitet ende kohë.



**Grafikoni 6.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së pestë të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022.

<sup>9</sup> Pyetësi i dërguar me datë 30.05.2023

## 4.6 Luftimi i Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Kjo objektivë përfshinte realizimin e 8 aktiviteteve, të cilat sipas përgjigjes së KGJK-së, nuk kanë arritur të realizohen në tërësi.

Nga përgjigjja që kemi pranuar nga KGJK, kanë potencuar se anëtarët e KGJK-së kanë zgjedhur Komisionin për Monitorimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe ky Komision ka

realizuar vizita nëpër gjykata ku edhe është njoftuar për gjendjen e lëndëve të kësaj natyre.

Rrjedhimisht, nga 8 aktivitetet e parapara në objektivën e gjashtë të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022 vetëm 1 prej tyre ka arritur të realizohet.

FOL ka pyetur KGJK se cilat nga këto aktivitete nuk kanë arritur të realizohen dhe KGJK ka potencuar në përgjigjen e saj se Komisioni po vazhdon të mbaj takime, por që realizimi i këtyre aktiviteteve do të realizohet gjatë vitit 2023. Pra, FOL ka kuptuar se në këtë objektivë kanë mbetur pa u realizuar edhe 7 aktivitetet e parapara me Planin e Punës së vitit 2022.



### AKTIVITETI I CILI KA ARRITUR TË REALIZOHET NË KUADËR TË KËSAJ OBJEKTIVE ËSHTË:

✓ Caktimi i Koordinatorit për Mbikëqyrjen e Zbatimit Planit Strategjik për Zgjidhjen

Efikase të Lendëve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Strategjisë

Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;




### AKTIVITETET TË CILAT JANË PARAPARË NË PLANIN E PUNËS SË KGJK-SË, QË NUK KANË ARRITUR TË REALIZOHESHIN:

- Themelimi i një grupi punues ndërinstytucional për të ofruar interpretim të unifikuar të "dashjes" dhe për t'i paraprirë mendimit juridik të Gjykatës Supreme;
- Gjykata Supreme të hartojë dhe miratojë një mendim juridik për të unifikuar interpretimit të "dashjes" siç përkufizohet në nenin 21 të Kodit Penal
- Qartësimi i disa elementeve interpretative që kanë të bëjnë me veprat penale të

- korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Ndërveprimi i sistemeve kompjuterike të shumë agjencive për të lehtësuar ndjekjen e veprave penale;
- Intensifikimi i punës në rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke krijuar kështu performancë të fuqishme të gjithmbarshme në hetimin proaktiv, ndjekjes penale, dënimeve përfundimtare dhe konfiskimeve përfundimtare

- të pasurive të fituara me veprë penale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rasteve të transferuara nga EULEX-i;
- Hartimi i formularëve standard të raportimit lidhur me Planin Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Rishikimi i raporteve të gjykatave për lëndët e kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.



LUFTIMI I KORRUPSIONIT  
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nga **8 aktivitetet**  
e parapara në  
objektivën e gjashtë të  
Planit të Punës së  
KGJK-së për vitin 2022  
**vetëm 1** prej tyre ka  
arritur të realizohet.

## 4.7 Miratimi i Legjislacionit Sekondar

Objektiva e 7 e Planit të Punës së KGJK-së përfshinë implementimin e

14 aktiviteteve prej të cilave, 9 kanë arritur të implementohen ndërsa 5

të tjera nuk kanë arritur të përfundohen për vitin 2022.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së<sup>10</sup>, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:

- ✓ Hartimi i Rregullores për emërimin e eksperteve gjyqësor;
- ✓ Hartimi i Rregullores për procedurën e zgjedhjes, emërimit, Pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- ✓ Hartimi i Rregullores për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Përformancën, dhe Disiplinimin e Bashkëpunëtorëve Profesional;
- ✓ Hartimi i rregullores për disiplinimin e anëtarëve të KGJK-së;
- ✓ Hartimi i rregullores për transferimin e gjyqtarëve;
- ✓ Hartimi i Rregullores për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve në mënyrë që njëra nga kriteret për vlerësimin e performancës së Kryetarëve të Gjykatave të jetë edhe menaxhimi i tij me vonesat/ shtyrjet si dhe raportimet për vonesat/shtyrjet e seancave;
- ✓ Hartimi i Udhëzuesit për procesin e hartimit dhe konsultimit publik të akteve normative të Këshillit;
- ✓ Hartimi i Udhëzuesit Themelor i Referimit për Organet Para-hetuese dhe Hetuese Disiplinore;
- ✓ Hartimi i Rregullores për Organizimin dhe Funkionimin e Sekretariatit;



### AKTIVITETET TË CILAT NUK KANË ARRITUR TË REALIZOHEN GJATË KOHË SË PARAPARË JANË:

- Hartimi i Rregullores për Normën e Gjyqtarëve Individual;
- Hartimi i Rregullores për vlerësimin e performances se kryesuesit të KGJKse, zv.kryesuesit të KGJK-se, anëtarëve të KGJK-se që shërbejnë më kohe të plote, kryetareve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- Hartimi i rregullores për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve;
- Hartimi dhe Plotësim-ndryshimi i Rregullores për Organizimin e brendshëm të Gjykatave për të siguruar harmonizimin e saj me Rregulloren e re për Avancim, përkitazi me kushtet që duhet plotësuar gjyqtari para
- avancimit/transferimit në mënyrë që të evitohet nevoja për rifillim të lëndës pas avancimit/transferimit;
- Hartimi i Plotësim ndryshimit të rregullores për përdorimin e SMIL;

Prej këtyre aktiviteteve të cilat nuk kanë arritur të realizohen në vitin 2022, duhet përmendur se aktivitetet si *Hartimi i rregullores për normën e gjyqtarëve individual dhe Hartimi i rregullores për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve* janë miratuar me 06.04.2023, pra 4 muaj më vonë se koha e paraparë.

Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.


Gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, nga kjo objektive kemi gjetur të dhëna për realizimin e aktiviteteve të objektivës së 7 ku edhe gjenden rregulloret e miratuar, si rregullorja e emërimit të ekspertëve gjyqësor, rregullorja për

disiplinimin e anëtarëve të KGJK-së, hartimi i rregullorës për transferim të gjyqtarëve, rregullorja për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve etj.

Sipas përgjigjes së KGJK-së, sfida kryesore për mos arritje të implementimit të të gjitha aktiviteteve është paraqitja e disa ndryshim/plotësimeve të akteve tjera normative nga Komisioni çështje normative së KGJK-së.

**64%**

I REALIZUAR



**36%**

I PAREALIZUAR



**Grafikoni 7.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të parealizuara të objektivës së shtatë të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022.

## 4.8 Plane tjera të KGJK-së

Objektiva e 8 e Planit të Punës së KGJK-së përfshinë 12 aktivitete dhe

të gjitha këto aktivitete kanë arritur të implementohen. Kjo është pra

objektiva e vetme e cila ka arritur të implementohet në tërësi.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:


- ✓ Evidentimi i hapësirave të arkivit nëpër gjykata;
- ✓ Asgjësimi i lëndëve në arkiva, të cilëve ju ka kaluar afati i ruajtjes;
- ✓ Finalizimi i propozimit për arkivin qendror të evidencave gjyqësore
- ✓ Ekzekutimi i buxhetit të KGJK-së sipas Ligjit "Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022" dhe sipas rishikimit të buxhetit;
- ✓ Planifikimi dhe përgaditja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2022-2024 sipas Instruksionit për përgaditjen e KASH-it nga MF;
- ✓ Planifikimi i buxhetit 2022 sipas qarkoreve buxhetore 2023/01 dhe 2023/02, në bashkëpunim me Gjykatat dhe shërbimet tjera të KGJK/SKGJK si dhe pas analizimit dhe shqyrtimit nga komisioni për buxhet, financa dhe personel i KGJK-së, dhe aprovimit nga Këshilli ti dërgohet Kërkesa Buxhetore e KGJK-së Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrisë së Financave;
- ✓ Zotimi dhe shpenzimi i buxheti 2021 për kategorin e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve si dhe shpenzimeve kapitale sipas planifikimit buxhetor dhe sipas kërkesave nga Njesitë tjera të KGJK/SKGJK dhe nga Gjykatat;
- ✓ Regjistrimi i të gjitha transaksioneve në regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit (SIMFK) si dhe mbajtja e evidences kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik në Sekretariatit e KGJK-së;
- ✓ Përgaditja e raporteve mujore financiare të buxhetit dhe të hyrave si dhe shpërndarja e këtyre raporteve Kryesuesit të KGJK-së, Drejtorit të SKGJK-së si dhe shërbimeve tjera të KGJK/SKGJK;
- ✓ Monitorimi i punës së gjykatave për buxhet dhe financa, rreth zbatimit në këtë fushë të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019 "Për ndarjen e Përgjegjësive të SKGJK-së dhe Gjykatave në çështjet e personelit, buxhetit dhe financave, logjistikës dhe prokurimit";
- ✓ Funkcionalizimi i softërit "Epasuria" nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për të ja përshtatur dhe për tu bërë i qasshëm për përdorim nga të gjitha Gjykatat e Kosovës;
- ✓ Regjistrimi i të gjithë pasurisë nën 1,000 € në sistemin "e-pasuria";
- ✓ Inventarizimi i plotë i pasurisë nga komisionet e inventarizimit;
- ✓ Tërheqjet-lëshimet e Urdhërpagesave (te arkatari) nga ana e referentëve për ekzekutime pas njoftimit nga banka për bllokim të llogarive të debitorëve. (Rekomandim nga Zyra Kombëtare e Auditimit);



Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.

Mirëpo, sipas përgjigjes së KGJK-së<sup>11</sup>, rreth implementimit të kësaj objektive në lidhje me ndonjë raport, apo ndonjë dokument tjetër që tregon se

kjo objektive është realizuar përgjigja e tyre ishte se nuk kanë të dhëna për këtë.



**Grafikoni 8.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektives së tetë të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022.

---

11 Përgjigja e KGJK-së e dërguar me datë 13.06.2023

## 4.9 Monitorimi i Zbatimit të Kornizës Ligjore dhe Rregullative

Kjo objektivë përfshinte implemtimin e 15 aktiviteteve, prej të cilave

9 kanë arritur të implementohen në tërësi ndërsa 8 aktivitete tjera nuk

janë përfunduar gjatë asaj periudhe kohore.



### SIPAS INFORMATAVE TË PRANUARA NGA ANA E KGJK-së<sup>12</sup>, AKTIVITETET E REALIZUARA ISHIN:

- ✓ Monitorimi i zbatimit të planeve të punës së grupeve punuese;
- ✓ Monitorimi i zbatimit të planit të punës së KGJK-së, të vitit 2022;
- ✓ Monitorimi i zbatimit të: 1. Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Veprimtarinë e Gjykatave; 2. Rregullores për Normën e gjyqtarëve individual; 3. Rregullores për Arkiva Gjyqësore; Planit i Veprimit për Zvogëlimin e Lëndëve Civile; 4. Politikat për zvogëlimin e shtyrjeve të seancave;
- ✓ Monitorimi i zbatimit të obligimeve ligjore për publikim të vendimeve gjyqësore nga të gjitha gjykatat në vend;
- ✓ Monitorimi i zbatimit të vendimeve të KGJK-se dhe akteve tjera nën ligjore;
- ✓ Monitorimi i punës së grupeve punues dhe koordinatorëve të caktuar nga KGJK;
- ✓ Monitorim i zbatimit të kriterëve ligjore për transferimin dhe avancimin e gjyqtarëve.



### AKTIVITETET TË CILAT NUK KANË ARRITUR TË REALIZOHEN GJATË VITIT 2022 PËR KËTË OBJEKTIVË JANË:

- Monitorimi i Strategjisë për zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra;
- Monitorimi i Strategjisë së Komunikimit;
- Krijimi i mekanizmit raportues dhe koordinimi i punëve të përkthimit për përkthyesit i sistemit gjyqësor;
- Finalizimi i planit të monitorimit të zbatimit të politikave nga gjykatat;
- Identifikimi dhe monitorimi i shkaqeve për shtyrje të seancave për vitin 2021 dhe ndërmarrja e masave konkrete për zvogëlimin e shtyrjes së seancave gjyqësore;
- Monitorimi i zbatimit të Planit strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar;
- Monitorimi i zbatimit të rregullores për trajnime;
- Monitorimi i rregullt i nevojave dhe mangësive të gjykatave dhe degëve themelore, përmes mekanizmit të strukturuar të bashkëpunimit me pikat kontaktuese në gjykata, që mund të jetë në baza mujore ose tremujore.

Mirëpo, sipas përgjigjes së KGJK-së<sup>13</sup>, rreth implementimit të kësaj objektive në lidhje me ndonjë raport, apo ndonjë dokument tjetër që tregon se kjo objektive është realizuar përgjigja e tyre ishte se nuk kanë të dhëna për këtë.


Realizimi i kësaj objektive (bazuar në të dhënat e pranuar nga KGJK) në mënyrë grafike është paraqitur në grafikën e mëposhtme.

Si përfundim, FOL ka pyetur KGJK-në<sup>14</sup> se cilat kanë qenë sfidat kryesore gjatë implementimit të

këtyre objektivave dhe aktiviteteve, dhe sipas KGJK-së ka pasur mungesë të koordinimit dhe komunikimit në mes të akterëve relevant. Gjithashtu është theksuar se për adresimin e këtyre problemeve apo sfidave që kanë pasur KGJK ka themeluar një Komision të veçantë.


**53%**

I REALIZUAR



**47%**

I PAREALIZUAR



**Grafikoni 9.** Përqindja e aktiviteteve të realizuara dhe të porealizuara të objektivës së nëntë të Planit të Punës së KGJK-së për vitin 2022.

13 Përgjigjja e KGJK-së e dërguar me datë 13.06.2023

14 Pyetje dërguar me datë 30.06.2023

## 5. Vlerësimet e Organizatave të Shoqërisë Civile për Realizimin e Planit të Punës së KGJK-së të vitit 2022

Për nevojat e përpilimit të këtij raporti, FOL ka realizuar edhe intervista me organizatat e shoqërisë civile të cila janë angazhuar në monitorimin e realizimit të këtij plani gjatë veprimitarisë së tyre.

Në pyetjet e dërguara tek përfaqësuesi i Institutit të Kosovës për Drejtësi theksoi si në vijim:<sup>15</sup>



Disa nga objektivat të cilat Këshilli i ka paraparë në këtë plan të punës, Këshilli ka dështuar ti përmbush. Ndër to ka qenë edhe miratimi i tri (3) rregulloreve dhe dy (2) plotësime/ndryshimeve të rregulloreve. Po ashtu, KGJK ka dështuar të miratojë edhe Planin e Veprimit për Zvogëlimi e Lëndëve Civile".



Pavarësisht se një numër i objektiveve të KGJK-së në Planin e Punës për vitin 2022 nuk ishin përmbushur, KGJK ka arritur që brenda kësaj periudhe të realizojë një numër të madh të planifikimeve si: miratimin e tetë (8) rregulloreve dhe dy (2) udhëzuesve".

Gjithashtu ka vlerësuar se aktiviteti rreth caktimit të Koordinatorit për Mbikëqyrjen e Zbatimit Planit Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lendëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka qenë një ndër aktivitetet më të rëndësishme që është realizuar në kuadër të objektivës së luftimit të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ndërsa nga pyetjet e dërguara tek përfaqësuesi i Grupi për Studime Juridike dhe Politike, theksoi si në vijim:<sup>16</sup>



KGJK ka arritur të realizojë aktivitetet e parapara, sidomos sa i përket hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, edhe pse një pjesë e tyre është ditur që nuk mund të përfundohen brenda kësaj periudhe kohore, qoftë për shkak të aktiviteteve të shumta të përfshira në Plan apo për shkak të kohës që duhet për realizimin e tyre (p.sh. Rregullorja për Normën e Gjyqtarëve Individual, Rregullorja për vlerësimin e performancës së kryesuesit dhe zv.kryesuesit të KGJK-së, anëtarëve të KGJK-së që shërbejnë më kohë të plotë, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës".

Sipas tij, duhet të shihet pozitive se gjatë vitit të kaluar KGJK ka arrit të miratojë 15 rregullore dhe 5 udhëzues të cilët rregullojnë veprimtari të veçanta të gjykatave dhe gjyqësorit në përgjithësi".

Mund të konkludojmë se edhe organizatat tjera monitoruese kanë shprehur se nevoja për krijimin e një komisioni ad-hoc për monitorimin e realizimit të planit të punës, është e domosdoshme sepse kjo do të ndihmonte që planet e punës të realizohen dhe aktivitetet të gjejnë zbatim në praktikë. Po ashtu kjo do të ngriste nivelin e efikasitetit të sistemit gjyqësor, transparencën, dhe llogaridhënien.

15 Intervistë e realizuar me datë 21.06.2023 me përfaqësuesin e IKD z.Lavdim Makshana

16 Intervistë e realizuar me datë 22.06.2023 me përfaqësuesin e GLPS z.Liridon Salihu

## 6. Rekomandime

Duke bërë ndërlidhjen në mes të gjetjeve të këtij raporti dhe inkurajimin për ngritje të efikasitetit të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

1. Planifikimi i realizimit të Planit të Punës të bëhet përmes objektivave dhe aktiviteteve të matshme, të cilat do të arrijnë të përmbushen brenda periudhës së paraparë.
2. Të formohet një Komision i veçantë, i cili gjatë tërë vitit do të monitoronte realizimin e planit të punës dhe do të asistonte në realizimin e aktiviteteve.
3. Planifikimi i objektivave të Planit të Punës të bëhet duke matur kapacitetin që ka sistemi gjyqësor për t'i përfunduar ato objektiva.
4. Niveli i realizimit të këtyre objektivave të monitorohet brenda periudhës tre apo gjashtë-mujore brenda vitit.
5. Komunikimi dhe koordinimi ndërmjet akterëve relevant që kanë për qëllim implementimin e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të eleminohet si sfidë dhe të punohet në drejtim të përmisimit të saj.

# Burimet

- Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor së Kosovës për vitin 2022 - [https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/reports/99914\\_KGJK\\_Plani\\_Punes\\_2022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/reports/99914_KGJK_Plani_Punes_2022.pdf)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji për Këshillin Gjyqësor së Kosovës - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18335>
- Pyetësori i realizuar me qëllim të nxjerrjes së të dhënave nga KGJK lidhur me implementimin e objektivave - [https://docs.google.com/forms/d/1T6JZ8p\\_apamZ4XBĚAcd7D-NQiZykYze1qffKO072ëEY/edit](https://docs.google.com/forms/d/1T6JZ8p_apamZ4XBĚAcd7D-NQiZykYze1qffKO072ëEY/edit)
- Ueb-faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor së Kosovës - <https://www.gjyqesori-rks.org/>
- Intervista e realizuar me Instituti i Kosovës për Drejtësi.
- Intervista e realizuar me Grupin për Studime Juridike dhe Politike.



FOL

